



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201701597/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Rekomandojmë shpejtimin e procedurës gjyqësore, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në gjykimin e dosjes me Nr.31020-00633-86-2017 akti, datë 13.02.2017, me Paditës K. S. nga qyteti i Durrësit.*

**Drejtuar :** **Z.Kastriot SELITA**  
**Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit**

**TIRANË**

***I nderuar zoti Kryetar,***

Në ankesën e tij datë 04.12.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi K. S. nga qyteti i Durrësit, ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore ndaj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në shqyrtimin e dosjes gjyqësore me Nr.31020-006386-2017 akti, datë 13.02.2017 me objekt detyrimin e Zyrës së Gjendjes Civile Durrës të ndryshojë mbiemërin nga S. në K. dhe konstatohet se në bazë të shortit elektronik të hedhur është caktuar si Relatore për gjykim Zj.E.SOFTA.

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë rezuloi se në bazë të kërkesë padisë paditësi Kurtish Sefuli i është drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së parë Durrës me objekt ndryshim mbiemëri nga Sefuli në Kurti dhe kjo Gjykatë në përfundim të gjykimit ka vendosur pa të drejtë rrëzimin e padisë.

Kundra këtij vendimi është ushtruar ankim nga paditësi Kurtish Sefuli në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila e ka regjistruar dosjen për gjykim me datën 13.02.2017, dhe si Relatore me short është caktuar Gjyqtarja E.SOFTA, e cila nga ana e saj nuk ka planifikuar akoma gjykimin e kësaj çështje gjyqësore.

Meqenëse ky ndryshim mbiemëri ka rëndësi të madhe për fëmijët e tij, paditësi ka kërkuar disa here shpejtimin e këtij gjykimi dhe përsëri kjo kërkesë nuk është realizuar nuk është bërë akoma ky planifikim gjykimi me arsyetim se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka ngarkesë të madhe pune dhe gjykimet nga ana e saj vazhdojnë të gjykohen vetëm sipas radhës së regjistrimit në sekretarin gjyqësore.

Në këto kushte paditësi K. S., është ankuar edhe tek institucioni i Avokatit të Popullit duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e tij për shpejtimin e këtij gjykimi në të ardhmen duke u bazuar në faktin se ka kaluar një kohe e gjatë afro 1 vit, nga koha e regjistrimit të saj për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, dhe akoma nga Relatorja e çështjes Zj.E.SOFTA, nuk është bërë planifikimi i këtij gjykimi.

Në këtë drejtim dhe në kuptim të kërkesave të nenit 3 të Ligjit me Nr.49/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”, ndër parimet e gjykimit administrativ kërkohet edhe sigurimi i një procesi të rregullt ligjor, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave, dhe se ky ligj synon kryesisht në thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjekteve dhe interesave të ligjëshme të punonjësve nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj Nr.14/2016 ka deklaruar se Ligji Nr.49/2012 ka parashikuar afate konkrete gjykimi për gjyqësorin në të tria shkallët e gjykimit, dhe në nenin 48/2 të këtij ligji përcaktohet qartë se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga Gjykata ku është paraqitur ankimi.

Gjykata Kushtetuese nga ana e saj gjithashtu ka theksuar në vendimin e saj se përderisa ligjvënësi ka caktuar afate kohore gjykimi të caktuara kjo do të thotë se ai, i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykata administrative e të gjitha shkallëve të gjykimit.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së RSH, përcaktohet se:

***” Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të Njeriut, nga administrata publike”***, dhe në nenin 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, thuhet se:

Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto detyra:

***”Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*** dhe për sa sipër  
Ju

#### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave për shpejtimin e procedurave gjyqësore, të dosjes gjyqësore me Nr.akti 31020-00633-86-2017 datë 13.02.2017, brenda të gjitha mundësive ligjore në të ardhmen dhe gjykimin e saj sa më shpejtë.

2.Lutemi, mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj, të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor, të parashikuar në ligj.

***Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,***

**AVOKATI POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**